



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 998 Prot.

Lezhë, më 22.01.2021

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____ Datë 22.01.2021

PËR
MIRATIMIN E ZGJEDHJEVE TË KRYETARËVE TË FSHATRAVE NË
NJËSINË ADMINISTRATIVE KALLMET

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" nenet 8, 53, 54 dhe 70; në përputhje me Vendimin Nr. 113, datë 26.08.2020 i ndryshuar, pasi u njoh me materialin zgjedhor dhe me propozim të Kryesisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjedhjen e Kryetarëve të Fshatrave në Njësinë Administrative Kallmet, të cilët janë:

- | | |
|-----------------------------|-------------------|
| 1.1. Fshati Kallmet i Madh | Z. Tonin Shtjefni |
| 1.2. Fshati Kallmet i Vogël | Z. Vital Simonaj |
| 1.3. Fshati Mërqi | Z. Alfred Doçej |
| 1.4. Fshati Rraboshtë | Z. Aleks Ndoj |

2. Brenda datës 28.02.2021 të mblidhen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse vulat ekzistuese të çdo fshati për t'i nxjerrë jashtë përdorimit sipas rregullave në fuqi.

3. Të merren të gjitha masat nga Kryetari i Bashkisë për përgatitjen e vulave të reja dhe brenda muajit shkurt 2021 t'u dorëzohen vulat e reja Kryetarëve të Fshatrave të miratuar sipas pikës 1 të këtij vendimi.

4. Aparati i Bashkisë të marrë të gjitha masat për njoftimin e ish Kryetarëve të Fshatrave për dorëzimin e dokumentacionit të Kryetarët e Fshatrave të zgjedhur dhe të miratuar sipas pikës 1 të këtij vendimi, detyrë e cila duhet të përfundojë brenda datës 28.02.2021.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

5. Kur ka raste të mosdorëzimit të dokumentacionit dhe vulës nga ish Kryetarët e Fshatrave brenda afatit të përcaktuar në pikat 2 dhe 4 të këtij vendimi, autorizohet Kryetari i Këshillit të Bashkisë për të bërë denoncimin në organet ligjore.
6. Shpërblimi mujor për Kryetarët e Fshatrave, të zgjedhur dhe miratuar sipas këtij vendimi, fillon në muajin shkurt 2021.
7. Ky vendim t'u bëhet i njohur nga Kryetari i Këshillit të Bashkisë, në rrugë zyrtare, të gjitha institucioneve shtetërore që trajtojnë probleme me pronat.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ERNEST RAKAJ

